



BASHKIA E TIRANËS
KRYETARI

URDHËRESË

Nr. 29682, datë 03.10 2016

Mbi

**“Organizimin e planit të lëvizjes së automjeteve, gjatë zhvillimit të aktivitetit
“Maratona e Tiranës 2016”**

Me qëllim, mbarëvajtjen e zhvillimit të aktivitetit “Maratona 2016”, të organizuar nga Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Atletikës, dhe në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1/1.1, nenit 25 pika 4 dhe nenit 64 shkronja “a” të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; nenit 5, pika 3, nenit 7, pikat 1 dhe 4 dhe nenit 37 të Ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, (i ndryshuar); nenet 29 dhe 42 të Vendimit Këshillit Ministrave nr.153, datë 07.04.2000 për “Miratimin e Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar),

URDHËROJ:

1. Qarkullimi i automjeteve gjatë zhvillimit të “Maratona 2016” me itinerar fillimi dhe mbarimi kryqëzimi i “Rruga e Durrësit” me “Dedë Gjo Luli” duke vazhduar përgjatë rrugëve “Rruga e Durrësit” – “Dritan Hoxha” – “29 Nëntori” – Mbikalimit deri në mbikalimin e “Rinasit”, do të bëhet i kufizuar, sipas planit lëvizës bashkëlidhur kësaj urdhërese, si më poshtë:
2. Ndalohet qarkullimi në rrugën “Dedë Gjo Luli”
 - Në kryqëzimin e bulevardit “Zog I” (sipas sensit veri-jug) me rrugën “Fortuzi”, do të jetë drejtim i detyruar djathtas;
 - Në kryqëzimin e “Rruga e Kavajës” (sipas sensit perëndim-lindje) me rrugën “Dedë Gjo Luli”, do të jetë drejtim i lejuar djathtas;
 - Në kryqëzimin e “Rruga e Dibrës” (sipas sensit lindje-perëndim) me bulevardin “Zog I”, do të jetë drejtim i detyruar djathtas.
3. Ndalohet qarkullimi në rrugën “Rruga e Durrësit”.

- Në kryqëzimin e rrugës “Fortuzi” (sipas sensit lindje-perëndim) me rrugën “Mine Peza”, do të jetë drejtim i detyruar djathtas;
- Në kryqëzimin e rrugës “Mine Peza” me “Rruga e Bogdanëve”, do të jetë drejtim i detyruar drejt;
- Në të gjitha rrugët që kryqëzohen me “Rruga e Durrësit”, do të pezullohet sensi dalës për në këtë rrugë.

4. Kufizohet qarkullimi në sheshin “Karl Topia”.

- Pezullohet qarkullimi në rrugën “Muhamet Gjollësia” (segmenti sheshi “Karl Topia”- “Sandër Prosi”) sipas sensit hyrës në shesh jug-veri. Sensi dalës i rrugës “Muhamet Gjollësia” nga sheshi “Karl Topia” është i hapur;
- Në kryqëzimin e rrugës “Asim Vokshi” (sipas sensit lindje-perëndim) me rrugën “Don Bosko”, do të jetë drejtim i detyruar djathtas, kurse drejt vetëm për mjetet e emergjencës dhe shërbimit urban qytetës;
- Në kryqëzimin e rrugës “Mine Peza” me rrugën “Asim Vokshi”, drejtim i detyruar drejt-djathtas.

5. Kufizohet qarkullimi në rrugën “Dritan Hoxha”.

- Pezullohet qarkullimi në rrugën “Dritan Hoxha” (sipas sensit jug-veri). Gjatë zhvillimit të aktivitetit korsia e dedikuar është e hapur në shërbim të mjeteve të emergjencës dhe shërbimit urban qytetës. Sensi veri-jug i rrugës “Dritan Hoxha” është i hapur;
- Në të gjitha rrugët në anën lindore që kryqëzohen me rrugën “Dritan Hoxha” pezullohet sensi dalës për në këtë rrugë;
- Në kryqëzimin e rrugës “Dritan Hoxha” me “Lord Bajronin” (sipas sensit të lejuar për qarkullim), do të jetë drejtim i detyruar drejt;
- Në kryqëzimin e rrugës “Lord Bajron” me “Gjergj Legisi”, do të jetë drejtim i detyruar djathtas.

6. Kufizohet qarkullimi në sheshin “Shqiponja”.

- Në kryqëzimin me rrethrotullimin e sheshit “Shqiponja” me rrugën “Vangjel Noti”, do të jetë drejtim i detyruar djathtas;
- Në kryqëzimin e rrugës “Teodor Keko” me “Dritan Hoxha” kalimi në rrethrotullim, do të jetë drejtim i detyruar djathtas;
- Në kryqëzimin e rrugës “29 Nëntori” me “Teodor Keko” kalimi në rrethrotullim, do të jetë drejtim i detyruar drejt-djathtas.

7. Kufizohet qarkullimi në rrugën “29 Nëntori”.

- Pezullohet pjesërisht qarkullimi në rrugën “29 Nëntori” sipas sensit jug-veri. Gjatë zhvillimit të aktivitetit dy korsitë lëvizjeje do të jenë të lira për qarkullim.
- Në hyrje të mbikalimit sipas sensit jug-veri, ndalohet qarkullimi drejt për në autostratë. Të gjitha mjetet do të lëvizin në korsitë e rezervuara devijim i detyruar djathtas.
- Sensi veri-jug i rrugës “29 Nëntori” është i lirë.

8. Iteneraret e linjave urbane që preken nga ky Urdhër ndërpriten gjatë zhvillimit të aktivitetit.

9. Të gjitha kufizimet e përshkruara më sipër janë në fuqi më datë 09.10.2016, nga ora 5⁰⁰ deri 14⁰⁰

10. Për zbatimin e kësaj urdhërese, ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit, Drejtoria e Përgjithshme e Komunikimit dhe Mardhënieve me Publikun, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Përgjithshme Nr.2 e Punëtorëve të Qytetit, Policia Bashkiake, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe Komisariatin e Qarkullimit Rrugor, Tiranë.

11. Kjo Urdhëresë hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar

Erion Veliaj

